



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 213/14 Prot.

Tiranë, më 5/4/2017

V E N D I M

Nr. 56 datë 5/4/2017

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 a/1, 32 dhe 39 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Universiteti Politeknik i Tiranës", Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

VËREN:

Në zbatim të Urdhrit nr. 35 datë 06/02/2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri"), Drejtoria e Hetimit Administrativ kreu hetim administrativ pranë kontrolluesit "Universiteti Politeknik i Tiranës", me objekti kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar (në vijim quajtur "Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale") dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "Universiteti Politeknik i Tiranës".

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin nr. 35 datë 06/02/2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi "Universiteti Politeknik i Tiranës", është një institucion publik i arsimit të lartë dhe ushtron aktivitetet nëpërmjet:

- Fakultetit të i Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN);
- Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU);
- Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit (FTI);
- Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike (FIM);
- Fakultetit të Gjeologjisë dhe i Minierave (FGJM);
- Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike (FIE);
- Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike (FIM&IF);
- Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM).

Kontrolluesi përpunon të dhëna personale kryesisht për subjektet e dhënave "punëmarrës", "studentë" dhe "vizitorë". Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale (nëpërmjet dokumentacionit në formatin letër) si dhe në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemeve të teknologjisë së informacionit të tilla si sistemi i video-vëzhgimit (CCTV), portali i studentit, portali zyrtar i institucionit dhe fakulteteve në varësi, pajisje kompjuterike etj.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:

1. Kontrolluesi ka njoftuar Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale që kryen por konstatohet se nuk është deklaruar përpunimi i të dhënave imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), qëllimi i përpunimit të këtyre të dhënave si dhe kategorinë e të dhënave sensitive “Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore”.
2. Kontrolluesi ka vendosur tabela informuese mbi prezencën dhe monitorimin e ambienteve nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV) por këto tabela nuk janë në përputhje me modelin standard të miratuar me Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit datë 05/03/2010 “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”.
3. Kontrolluesi nuk ka publikuar “Politikat e Privatësisë” në lidhje me të dhënat të cilat mblidhen nëpërmjet portalit zyrtar <http://www.upt.al> si dhe në portalet e fakulteteve nën varësi:
  - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit <http://www.fin.edu.al>;
  - Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit <http://www.fti.edu.al>;
  - Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave <http://dibmin-fgjm.org>;
  - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike <http://fie.upt.al>;
  - Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Fizike <http://www.fimif.edu.al/>;
  - Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit <http://www.geo.edu.al>.
4. Kontrolluesi nuk ka nënshkruar “Deklaratë Konfidencialiteti” me punëmarrësit.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit hartoi procesverbalin dhe e lexoi në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit, të cilët u shprehën se: “Ne do ti paraqesim pretendimet tona brenda një afati 5 ditor pune, së bashku me dokumentacionin shoqërues”.

Me shkresën nr. 213/2 prot. datë 27/02/2017, kontrolluesi “Universiteti Politeknik i Tiranës” ka parashtruar pretendimet lidhur me shkeljet e konstatuara nga grupi i kontrollit të Zyrës së Komisionerit, gjatë zhvillimit të hetimit administrativ, ku shpjegon:

*“Lidhur me konstatimin e pikës së parë të procesverbalit, U.P.T. ende nuk ka filluar të përpunojë të dhëna nëpërmjet sistemit të “Video-Vëzhgimit” (CCTV) dhe njoftimi pranë Zyrës së Komisionerit nuk është bërë për arsye se sistemi është në fazë testimi. Kameran survejuese janë të sapo vendosura në korridoret e institucionit dhe ende nuk kanë filluar të regjistrojnë ose grumbullojnë informacion. Sapo të hartohet dhe miratohet rregullorja për administrimin e sistemit të video – vëzhgimit dhe të vendoset data e fillimit të regjistrimit nga kamerat survejuese. Nga ana e institucionit do të merren të gjitha masat sipas legjislacionit në fuqi, për njoftimin e Komisionerit, bazuar në nenin 21/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 i ndryshuar.*

*Lidhur me konstatimin e pikës së dytë të procesverbalit, në ambientet e U.P.T. janë vendosur provizorisht tabela informuese nga kompania e cila ka instaluar sistemin e video-survejimit (CCTV), deri në miratimin e rregullores për administrimin dhe funksionimin e tij.*

*Lidhur me konstatimin e pikës së tretë të procesverbalit, UPT nuk mbledh të dhëna nëpërmjet portalit zyrtar [www.upt.al](http://www.upt.al) dhe portaleve të njëjësive përbërëse. Faqet e internetit mundësojnë për publikun informacione të ndryshme mbi veprimtarinë e institucionit, programet e studimit që ofrohen si dhe kuadri ligjor.*

*Lidhur me konstatimin e pikës së katërt të procesverbalit, sa i përket nënshkrimit të “Deklaratës së Konfidencialitetit”, në institucionet e arsimit të lartë, kriteret e punësimit dhe*

lista e dokumentacionit përkatës përcaktohen nga departamentet në çdo fakultet. Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe në statutin e U.P.T., departamentet si njësi bazë në I.A.L. kanë të drejtë të përcaktojnë kriteret e punësimit për çdo kandidat si dhe listën e dokumentacionit përkatës. Menjëherë nga ana e institucionit do të merren masat për njoftimin e njësive bazë që të përfshijnë në listën e dokumentacionit edhe “Deklaratën e Konfidencialitetit”.

Në përputhje me Ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, U.P.T. do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve.”

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, kontrolluesi “Universiteti Politeknik i Tiranës” është njoftuar zyrtarisht për pjesëmarrje në seancën dëgjimore që do të zhvillohej në datën 16/03/2017, për të ushtruar të drejtën e tij për tu dëgjuar.

Përfaqësuesi i kontrolluesit, në këtë seancë dëgjimore, u ka qëndruar pretendimeve të paraqitura në shkresën nr. 213/2 prot. datë 27/02/2017 pranë Zyrës së Komisionerit.

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi pretendimet e kontrolluesit dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ, konkludon:

1. Në lidhje me pretendimin e parë:

Në bazë të provave të administruara gjatë kontrollit administrativ, sistemi i video-survejjimit (CCTV) është konstatuar në funksionim dhe të dhënat imazhe video ishin të regjistruara për periudhën 01-20/02/2017, çka do të thotë se kontrolluesi është në proces përpunimi të të dhënave imazhe-video nëpërmjet këtij sistemi.

Referuar:

- nenit 21 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale sipas të cilit - “1. Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë.”
- nenit 22 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale - “Njoftimi duhet të përmbajë b) qëllimin e përpunimit të të dhënave personale; c) kategoritë e subjekteve të të dhënave dhe kategoritë e të dhënave personale;”

konkludoj se kontrolluesi, përpara fillimit të një përpunimi të ri, duhej të njoftonte Zyrën e Komisionerit në lidhje me këtë përpunim të ri të të dhënave, qëllimin e përpunimit, kategoritë e të dhënave dhe subjektet e të dhënave që ndikohen nga ky përpunim. Kontrolluesi gjithashtu, duhej/t të konsultohet/et edhe me aktet nënligjore të Komisionerit, të cilat përcaktojnë rregulla dhe udhëzime për aktivitete dhe procese specifike të përpunimit të të dhënave personale.

2. Në lidhje me pretendimin e dytë:

Në bazë të provave të administruara gjatë kontrollit administrativ, është konstatuar se janë vendosur tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV) në ambientet e brendshme në të cilat kontrolluesi ushtron aktivitet, por ato nuk e përmbushin plotësisht qëllimin e tyre për arsye se nuk japin informacion të plotë në lidhje me zotëruesin e këtij sistemi, të drejtat e subjektit të të dhënave etj., për të qenë në përputhje me :

- Nenin 18 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale sipas të cilit - “1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të

*dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij."*

- Udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".

3. Në lidhje me pretendimin e tretë:

Çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale dhe pavarësisht nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare në internet, ka detyrim që të publikojë "Politikat e Privatësisë", pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet portalit zyrtar të kontrolluesit. Publikimi i "Politikave të Privatësisë" përmbush më së miri qëllimin e nenit 18 të ligjit sipas të cilit - "1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit..."

4. Në lidhje me pretendimin e katërt:

Nënshkrimi i "Deklaratës së Konfidencialitetit", është një mekanizëm i cili vë përpara përgjegjësisë për ruajtjen e konfidencialitetit, çdo punëmarrës që përpunon të dhëna personale gjatë dhe për shkak të detyrës. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale sipas të cilit - "Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj", Komisioneri ka nxjerrë Vendimin nr. 6 të datë 05/08/2013 për "Përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale", si një mjet për të garantuar zbatimin e ligjit.

Mospërmbushja e detyrimit për të nënshkruar "Deklaratë Konfidencialiteti" përbën shkelje të nenit 28 të Ligjit të sipërcituar dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit datë 05/08/2013 për "Përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale".

Kjo shkelje, në kuptim të nenit 39/1 shkronja "dh" të Ligjit Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë:

*"dh) - kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë."*

Kontrolluesi Universiteti Politeknik i Tiranës, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Sipas procesverbalit të datës 21/02/2017, në të cilin është konstatuar mbledhja nga kontrolluesi e të dhënës sensitive "Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore" për ta bërë pjesë të dosjes së personelit akademik dhe administrativ, konstatojmë se qëllimi i kësaj kërkese përmbushet më së miri nga mekanizmi i vetëdeklarimit të subjektit të të dhënave sipas nenit 2, pika 8 të Ligjit nr. 9614 datë 21/09/2006 "Për Certifikatat Elektronike të Gjendjes Gjyqësore".

Ky nen shprehet se: "Vetëdeklarim i personit" është deklarimi që bën personi përpara institucionit publik ose privat, shqiptar ose të huaj, për faktin nëse është apo jo i dënuar, i

*shoqëruar me autorizim me shkrim dhe me dokument identifikimi, për të lejuar institucionin të bëjë verifikimet e nevojshme”, të aplikojë vetëdeklarimin e punëmarrësit për faktin nëse është apo jo i dënuar.”*

Sa më sipër mund të vlerësohet nga kontrolluesi “Univertiteti Politenik i Tiranës” zbatimi i këtij mekanizmi kundrejt administrimit në dosjet e personelit të “Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore”.

Sa i përket shkeljeve të konstatuara dhe parashtruara në pikat 1, 2, 3 dhe 5 këtu më sipër, Zyra e Komisionerit, duke vlerësuar bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e hetimit, i cili ka qenë i ndërsjellë në funksion të zbatimit të ligjit si dhe qëndrimin e kontrolluesit ndaj konstatimeve të grupit të hetimit, në bazë të nenit 31 a/1 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, do të dalë me rekomandime lidhur me zbatimin e detyrimeve të përcaktuara sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 28, 29, 30, 31, 32 dhe 39/1/dh të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

### **V E N D O S A :**

1. Dënimin e Kontrolluesit “Universiteti Politeknik i Tiranës” me gjobë në vlerën **30.000 (tridhjetë mijë)** lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe Vendimit nr.6 datë 05/08/2013 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”;
2. Kontrolluesi “Universiteti Politeknik i Tiranës”, në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të marrë masat për të përfshirë në faqen e tij të internetit rubrikën “Politikat e Privatësisë”;
3. Kontrolluesi “Universiteti Politeknik i Tiranës”, në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të marrë masat për informimin e subjekteve të të dhënave mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV), në përputhje me Udhëzimin nr. 3 datë 05/03/2010 “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”;
4. Kontrolluesi “Universiteti Politeknik i Tiranës”, në zbatim të nenit 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të nënshkruajë “Deklaratën e Konfidencialitetit” me çdo punëmarrës që akseson të dhëna personale;
5. Kontrolluesi “Universiteti Politeknik i Tiranës”, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të përditësojë njoftimin pranë Komisionerit lidhur me kategorinë e të dhënave të përpunuara (konkretisht përpunimin e të dhënave imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), qëllimin e përpunimit të këtyre të dhënave si dhe kategorinë e të dhënave sensitive “Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore”;
6. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të kryhen plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikat 2, 3, 4 dhe 5 të këtij Vendimi, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni.

7. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave
8. Gjoba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 5/4/2017

